



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.315/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual **Naim Mehulli**, ne çështjen juridike te paditëses Xh.I nga te cilin e përfaqëson Av. I.H , kundër te paditurës Komuna e, për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore me dt.07.12.2018 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESERISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses XH.I,

II.OBLIGOHET e paditura Komuna et'ia paguajë paditëses ne emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënëse te e paditura për mbi 30 vjet te përvojës se punës ne vlerë te një page bazë, shumën prej **465.98 euro**, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për në pension, shumën prej **1397.94 euro**, respektivisht shuma totale prej **1863.92 euro (një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tri, e nëntëdhjetë e dy cent)**.

III.OBLIGOHET e paditura Komuna et'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej 279 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

IV.REFUZOHET E PA BAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditëses XH.I, për kompensimin e dy pagave për shpërblim jubilar ne shumën prej 931.96 euro.

A r s y e t i m

Paditësja përmes te autorizuarit te saj me datën ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe 3 për shpërblimin jubilar ne shumën e përgjithshme prej 2795.88 euro.

Gjykata, me dt. 06.12.2018, ka caktuar seancë për shqyrtim përgatitore, ne te cilën ka prezantuar i autorizuari i paditëses dhe përfaqësuesi i të paditurës.

I autorizuari i paditëses në këtë seancë deklaroi se mbetem ne tersi sipas padis dhe kërkesëpadisë, me një propozim alternativ qe konform dispozitave të kontratës kolektive të arsimit të Kosovës, kërkesëpadinë e precizojmë në shumë prej 1818.98 euro, pasi që nëse aplikohet Kontrata Kolektive e re e vitit 2017 paditëses do ti takonte 3+1 ndërsa

nëse do të aplikohet marrëveshja e përgjithshme kolektive të njëjtës do të takonte 3+3 paga. Nga dëshmitë materiale në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja posedon përvojë pune prej 30 vite 8 muaj e 2 ditë. Nga qarkullimi bankar BPB të datës 25.04.2018 vërtetohet se paditësja për muajin janar, shkurt e mars ka realizuar te e paditura pagën mujore prej 965 euro.98 cent. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë për hartimin e padisë 104 euro, për një përfaqësim prej 135 euro dhe ne emër të taksës gjyqësore në shumë prej 40 euro.

Përfaqësuesi i te paditurës deklaroi se e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë duke pasur parasysh mungesën e mjeteve financiare nga buxheti komunal. Është evidente që paditësja ka punuar në sektorin e arsimit dhe po ashtu në bazë të shkresave të lëndës nuk është kontestuese përvoja e saj.

Gjykata, ne procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: Letërnjoftimin për paditësen, Vendimi për caktimin e pushimit të marrëdhënies së punës i dt...., Njoftimi nga e paditura, Pasqyra e llogarisë bankare e dt....., Vërtetimi nga SH.F.M.U “....” i dt., Vërtetim nga SH.F.M.U “...” i dt., Vërtetim nga SH.F.M.U “....” ... i dt.03.12.2018 nga Sh.F.M.U “.....” i dt, Vërtetim nga shkolla fillore e mesme e ulët “.....” i dt.03.12.2018, Vërtetim nga shkolla fillore e mesme e ulët “....” Mitrovicë e dt..... dhe pas shqyrtimit bashkërisht gjitha këtyre provave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Nuk është kontestues fakti që paditësja ka qene në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse nga datat: deri më ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nga SH.F.M.U dt....., deri më ky fakt vërtetohet në bazë të Vërtetimi nga SHFMU “...” dt., ... deri më ... ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nga SHFMU “...” dt , 14.02.1990 deri më 08.06.1990 dhe nga 21.02.1992 deri më 01.09.1998 ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nga SHFMU GJ.K..... te dt.....,deri më ky fakt vërtetohet në bazë të vërtetimit nga SHFMU “.....” të datës si dhe 01.01.2004 deri më 20.04.2018 ky fakt vërtetohet në bazë te vërtetimit nga SHFMU “...” te dt.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësi e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 465.98 euro, ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e datës 25.04.2018 për periudhën 01.01.2018 deri me 25.04.2018.

Nuk është kontestues se paditësja i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimi të kushteve për pension të pleqërisë, e kjo vërtetohet nga vendimi nr., i dt. 10.04.2018.

Nuk është kontestuese se paditësja ka paraqitur kërkesë tek e paditura sa i përket realizimit të kësaj kërkesë lëndore, kjo vërtetohet ne baze te njoftimit te të paditurës dt....., e cila është refuzuar nga paditura se Komuna nuk ka gjetur bazë te kompensoi

paditesen, kjo vërtetohet nga njoftimi kompensimi pas pensionimit Nr..... dt. 23.04.2018.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesëpadisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 e cila parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 30 vjet të përvojës në vlerë të një page bazë” dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parasheh se “punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit”.

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditëses e cila vërtetohet në bazë të vërtetimit të dt. 25.04.2018, se paditësja ka marrë tri pagat e fundit në vlerë prej 465.98 euro cent dhe kontrata e punës me numër të protokollit 405 e dt.08.09.2015 ku paga bazë është parapare 518.34 euro si dhe nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4, dhe nenit 35 par 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017.

Prandaj, gjykata bazuar në nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej **1863.92** euro, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumë prej **1397.94** euro dhe në emër të shpërblimit jubilar (një page bazë) shumë prej **465.98** euro.

Gjykata, me rastin e vendosjes sipas dispozitivit si me lartë, pati parasysh edhe pretendimet e të paditurës të shprehura gjatë seancës gjyqësore, mirëpo të njëjtat pjesërisht i morri parasysh me rastin e aplikimit të Kontratës Kolektive, ashtu që e aplikoi Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 si ligj special, ndërsa kundërshtimet e tjera nga e paditura, gjykata me arsyet e cekura me lartë, i refuzoi si të pabazuara, duke iu referuar provave në shkresat e lëndës.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e cekur si alternativ nga ana e të autorizuarit të paditëses në seancën e datës 06.12.2018 pasi që Gjykata lidhur me vendosjen u bazua në Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, pasi që e njëjta është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e rregullon këtë çështje në mënyrë specifike, ndërsa sa i përket bazës në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të datës 18.03.2014, me të cilën parashihet se “punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit të tij njihet e drejta në shpërblim jubilar në lartësi të tri pagave mujore të tij” gjykata nuk mund ta marrë për bazë Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive për faktin se nëse dy ligje e rregullojnë të njëjtën situatë, ligji që rregullon një çështje specifike (lex specialis) anashkalon ligjin që rregullon vetëm çështjet e përgjithshme (lex generalis), pra

ne rastin konkret duhet te aplikohet Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 18.04.2017 si ligj special.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro ne emër te përpilimit te padise dhe 40 euro në emër te taksës gjyqësore.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.315/2018 data 07.12.2018

GJYQTARI
Naim Mehulli

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.